

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Të fala babës me respekt"/ Bosi i klanit libanez shkakton tërmet politik në Berlin
ADRESA	https://lajmifundit.al/te-fala-babes-me-respekt-bosi-i-klanit-libanez-shkakton-termet-politik-ne-berlin-i1338415
BURIMI	lajmifundit.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:59:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 14:04:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d2a0d34518a88e9e5a193933aa424390f6ce2c13f87a801f44f0351db1fb73fa
TEKSTI	b49b1140658671df337a226e811c88fe09e24e14557debb3f754cac63ad89b45
PAMJA	5ce72dfda6763af2986a686ef4d65d9b771d6d0f49cf0be67ecca39a7816befd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8afdb3bbda2a959020069165c213618b02ab35c658a2357a657909a1f7057bab
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8afdb3bbda2a959020069165c213618b02ab35c658a2357a657909a1f7057bab>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

I konsideruar "kumbar" i narkotrafikut / Kush është Shpëtim Aliu alias "Salvatore", shqiptari i arrestuar në Rusi

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Operacioni ndërkombëtar "The Wanted" / Finalizohen dy fazat e reja, arrestohen në Rusi dhe Itali dy pjesëtarë të rrjeteve kriminale

[Lexo lajmin e plotë](#) →

"Tabela e rezultateve", loja e rrezikshme që po përhapet në rrjete sociale mes të rinjve

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga "kokat" e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Familjet e ish-krerëve të UÇK-së refuzojnë takimin me Haxhiun pa ndryshuar ligji për Specialen

[Lexo lajmin e plotë](#) →

"Të fala babës me respekt"/ Bosi i klanit libanez shkakton tërmet politik në Berlin



LAJMI FUNDIT / 23 SEPTEMBER 2026, 14:04

Shpërndaje

BOTA



Në zgjedhjet në Berlin ka fituar partia e majtë DIE LINKE. Kryetare e kryeqytetit të Gjermanisë ka gjasa të bëhet Elif Eralp, një gjermane me origjinë turke. Por befasi ka lindur një problem: lidhjet e së majtës me familjen Remmo nga Libani, pjesëtarët e së cilës janë bërë të pasur edhe me qindra vepra penale. Situata ka arritur deri aty, sa që prokurorët gjermanë kanë frikë nga krimi i organizuar.

Të dielën që shkoi, në Berlin u mbajtën zgjedhjet për parlamentin e qytetit me rrethinë. Siç parashikonin anketat, më së shumti vota mori partia DIE LINKE, e majta. Kryekandidatja e partisë, Elif Eralp, ka gjasa të bëhet kryetare e Berlinit. Do të ishte njeriu i parë me origjinë të huaj në krye të metropolit gjerman. Eralp u lind më 1981 në München; një vit më parë, prindërit e saj - të dy aktivistë sindikalë - ikën nga Turqia si pasojë e puçit ushtarak të kryer nga shefi i armatës Kenan Evren. Dikur kryetar i Berlinit ka qenë Willy Brandt, ikona e socialdemokracisë gjermane.

Eralp duhet të gjejë partnerë koalicioni. Në shprehje vijnë socialdemokratët dhe të gjelbrit. Por sa janë reale gjasat për koalicion? Përfaqësuesit e këtyre dy partive kanë rezerva ndaj DIE LINKE për arsye që do përmenden në vijim të këtij teksti.

DIE LINKE është mjaft e popullarizuar në Berlin. Gati gjysma e votuesve të moshës 16 deri në 24 vjeç kanë votuar për këtë parti (43 për qind). Nuk janë vetëm të rinjtë e varfër që simpatizojnë këtë parti. Edhe fëmijët e familjeve të pasura, mbi të gjitha vajzat, e mbështesin DIE LINKE. Një nga arsyet: të rinjtë besojnë se po plaçkiten nga të pasurit, ankohen se ose nuk ka fare banesa në Berlin, ose ato që janë në dispozicion thjesht s'mund t'i paguajë një njeri normal, andaj votojnë të majtën, e cila ka një premtim sa madhështor, aq edhe absurd: shpronësimin e ndërmarrjeve të patundshmërive. Socialdemokratët kanë thënë: me neve kjo s'bëhet.

MOTI NE TIRANE

Tirana, Albania

POLITIKË

"E ke dëgjuar atë këngën Zegjine, Zegjine..." / Aktivistja i zë pritë deputetes së PS në zyrat e Kuvendit, kërcët debati (VIDEO)

POLITIKË

"Pse u hoq dëshmia e penalitetit dhe për kë?": Deputetja e PS, Koçeku, ngre pikëpyetje për Universitetin e Shkodrës

TRENDING

8,500 dëshmi konkrete të mbështetjes financiare nga sigurimi shëndetësor në SIGAL

One Albania sjell inovacionin Wi-Fi 7 për internetin në shtëpi

Të dielën në mbremje, simpatizantët e DIE LINKE u tubuan në një sallë në qarkun Neukölln në Berlin për të festuar fitoren. Me fytyrë të qeshur, Elif Eralp mbajti një fjalim para fytyrave të qeshura, mes tyre shumë gra. Eralp foli si të ishte tashmë me një këmbë në zyrën e kryetares së Berlinit.

Diku në sallë u shfaq edhe një burrë, i gjatë, me mjekër të shkurtër, nga ata tipat që më mirë është të mos e shikosh direkt në sy. Ishte Issa Remmo, në Berlin dhe mbarë Gjermaninë i njohur si shef i klanit me të njëjtin emër. Ndonëse Remmo nuk është dënuar asnjëherë nga drejtësia gjermane, për familjen e tij ekziston bindja, ka edhe fakte si dhe aktgjykime, se bukën e gojës dhe lukse të tjera i siguron kryesisht nga të ardhurat e grabitjeve të armatosura dhe shantazheve për haraç. Këto mjete pastaj familja Remmo, si çdo investitor serioz, i investon në patundshmëri - jo në Liban, por në Berlin.

Si është e mundur që shefi i një klani të tillë të shfaqet në festën e partisë që i fitoi zgjedhjet në Berlin? Partia DIE LINKE reagoi si pula pa krye dhe u arsyetua se Remmo nuk ishte i ftuar në festën partiake, por duket se Remmo e konsideronte se as që ka nevojë për ftesë - ndihej pak si në shtëpi aty. Pastaj u bënë publike detaje të tjera që kundërshtonin arsyetimin e DIE LINKE se nuk kishte asnjë lidhje me klanin Remmo. Issa Remmo deklaroi se DIE LINKE është e para parti gjermane nga e cila ndihet i mbështetur. Firas Remmo, njëri nga djemtë e kreut të klanit, publikoi në Instagram copëza nga një shkëmbim mesazhesh me deputetin e partisë DIE LINKE në Bundestag, Ferat Koçak, të zhvilluar në shkurt. Koçak i shkruante Firas Remmos t'i përcillte "përsëritjet me respekt" babait të tij. Babai - që të jetë edhe njëherë e qartë - është Issa Remmo. Deputeti Ferat Koçak u mundua të distancohet nga ky episod i jetës së tij politike, premtoi se do t'i ndriçojë krejt paqartësitë në lidhje me këtë çështje dhe hëpërhë u tërhoq nga jeta aktive publike.

Por problemi ka mbetur dhe ka të bëjë me rolin e krimit të organizuar në Berlin, i cili dominohet nga familja Remmo dhe klane të tjera arabe. E majta politike shpesh tregohet naive ndaj tyre. Në emër të luftës kundër racizmit, ajo shpesh thotë se nuk duhet të flitet për "kriminalitet klanesh", sepse kjo na qenkësh diskriminuese. Ndërkohë, mediat gjermane shkruajnë se drejtësia në Berlin ka frikë nga krimi i organizuar.

Gazeta "Bild" njofton se informatorë nga mafia turke kanë raportuar për ekzistencën e listave të vrasjes me emra prokurorësh dhe gjyqtarësh gjermanë. Vite më parë, disa gjyqtarë u kërcënuan nga dilerët e mëdhenj të drogës dhe u vunë nën mbrojtje nga autoritetet. "Biznesmenë me origjinë turke shantazhohen nga banda kriminale, ndërsa të shtënat me armë po bëhen gjithnjë e më të shpeshta. Autorët në disa raste sillen ekstra me avion nga Turqia", shkruan gazeta "Frankfurter Allgemeine Zeitung".

LEXONI GJITHASHTU



Vlora Hyseni mbi 130 telefonata me Ergys Agasin, i kërkuari mbante në makinë dosjet sekrete të SHISH



Mbi 7 muaj pa dëmshpërblim, fermerët e Maliqit marrin vendimin ekstrem



9 vite burg shqiptarit në Gjermani, tentoi të vriste mësuesen sepse i ofendoi profetin Muhamed

Nuk dihet sa i madh është klani Remmo, por vetëm në zonën e Berlinit, sipas hulumtimeve të SPIEGEL TV, familjes Remmo i përkasin rreth një mijë persona. Sipas DER SPIEGEL, anëtarët e parë të familjes arritën në Berlinin Perëndimor në vitet tetëdhjetë nga Libani. Ata kërkuar azil, pjesërisht disa herë radhazi, kur kërkesa refuzohej. Shumica e pjesëtarëve të familjes Remmo nuk u dëbuan, edhe pse kërkesat e tyre për azil u refuzuan. Vargu i veprave penale të familjes Remmo është i gjatë: pastrim parash, lëndime trupore, shantazh për haraç, vjedhje spektakulare. Në vitin 2018, autoritetet konfiskuan përkohësisht 77 prona të paluajtshme që ishin në pronësi të anëtarëve të familjes së madhe Remmo.

POLITIKË

"Bela me Taon janë shokë, do bëhet kryetar Kuvendi", zbardhen SMS-të mes Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit në dosjen e SPAK

POLITIKË

"Territorialja", përplasja te ligjet, demokratët braktisin mbledhjen, PS vijon e vetme punën

ME TË LEXUARAT

"Zbrazti karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e...

[Lexo lajmin e plotë](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plotë](#)

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plotë](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plotë](#)

Partia DIE LINKE nuk gezon vetem simpatine e nje pjese te madhe te te rinjve, por edhe te personave me prejardhje të huaj, sidomos atyre me origjinë nga bota arabe. Ata e mbështesin këtë parti edhe për shkak se ajo tregohet mjaft tolerante ndaj antisemitizmit. Ndërsa veprimet e qeverisë së Izraelit në Gaza mund të kritikohen ashpër, problemi i antisemitizmit qëndron në nxitjen e urrejtjes ndaj çdo njeriu me origjinë hebraike. Ndaj skandaleve antisemite DIE LINKE nuk ka reaguar me vendosmëri. Është problematike kur deputeti i DIE LINKE, Ferat Koçak, pas fitores së partisë së tij në Berlin u pa në një skenë pothuaj vëllazërore me Ibrahim Ibrahim, një përfaqësues i Komitetit Kombëtar Palestinez, një organizatë ombrellë për organizatat terroriste Hamas dhe PFLP në Berlin. Ibrahim e ka lavdëruar publikisht kryeterroristin e Hamasit, Jahja Sinvar, duke e quajtur "udhëheqës të palëkundur" dhe "hero martir". Në festën e partisë DIE LINKE, Ibrahim u pa pranë kreut të klanit, Issa Remmo.

ME TE LEXUARAT

"Zbrazni karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e Gjovalin Lazrit

[Lexo lajmin e plotë](#)

NA SHKRUAJ

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

[Kliko për më shumë informacion](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plotë](#)

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plotë](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plotë](#)

"Askush nuk është mbi ligjin"/ Rama shkarkon menjëherë Vlorë Hysenin: Pas kthimit në Tiranë zgjedh drejtuesin e ri të SHISH

[Lexo lajmin e plotë](#)

Sekuestrohet hoteli "Central Park Premium" në Ksamil, u ndërtua pa leje! Ja kujt i përket

[Lexo lajmin e plotë](#)

"Ka gjëra që edhe ne që i dimë nuk flasim dot"/ Artan Hoxha: Ka fakte tronditëse për Ballukun, gropa u hap

[Lexo lajmin e plotë](#)

LAJMI FUNDIT   **KUSH JEMI** **KONTAKT REDAKSINË** **TE DHENAT PERSONALE** **COOKIES**

LajmiFundit merr pjesë në programe të ndryshme marketingu ku mund të përfitojë komisione për produktet e zgjedhura në artikujt e publikuar.

Created & Monetized by **Mediadesk**

REGJISTROHU NË NEWSLETTER

OK

Ju do të mëmi njoftime periodike me Lajmet e Fundit.